

DEKLARATË E PËRBASHKËT

Shoqëria civile i kërkon Kuvendit të mos cenojë transparencën, shqyrtimin parlamentar dhe konsultimin publik në procedurat e përshpejtuara për legjislacionin e integritit evropian

Deklaratë e përbashkët mbi projektvendimin për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë

13 Mars 2026

Tiranë, Shqipëri

Organizatat e shoqërisë civile nënshkruese të kësaj deklaratë, kanë ndjekur me vëmendje projektvendimin e paraqitur më 2 mars 2026 për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ne përshëndesim angazhimin e Kuvendit për të forcuar rolin e tij në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe për të përmirësuar efikasitetin e punës parlamentare. Negociatat e anëtarësimit kanë hyrë në një fazë intensive dhe një parlament funksional është thelbësor për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian.

Njëkohësisht, mbështesim procesin e integritit evropian dhe përpjekjet për përafrimin e legjislacionit me acquis. Megjithatë, efikasiteti i procesit legjislativ duhet të shoqërohet me standarde të larta transparence, përfshirjeje publike dhe debat parlamentar. Korniza e monitorimit të Komisionit Evropian vlerëson jo vetëm ritmin e përafrimit të legjislacionit, por edhe cilësinë dhe përfshirjen e grupeve të interesit si pjesë e funksionimit të institucioneve demokratike. Këto standarde reflektohen gjithashtu në praktikat parlamentare të vendeve të BE-së, në udhëzimet e OECD dhe programit SIGMA, si dhe nga angazhimi i [Parlamentit Evropian](#) — të cilat theksojnë rëndësinë e transparencës, konsultimit publik dhe shqyrtimit parlamentar si elemente thelbësore të procesit legjislativ cilësor.

Në këtë kuptim, këto parime përbëjnë bazën e një demokracie funksionale dhe procesi legjislativ transparent, në përputhje me standardet evropiane të qeverisjes demokratike të parashikuara në Udhërrëfyesin për Funksionimin e Institucioneve Demokratike të Grup Kapitullit — Themeloret. Për këtë arsye, çdo reformë e rregullave procedurale të Kuvendit duhet të synojë jo vetëm rritjen e efikasitetit, por edhe forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes publike, veçanërisht në kontekstin e integritit evropian.

Kjo deklaratë ngre shqetësimin për dy elemente të projektvendimit: procedurën e përshpejtuar për legjislacionin që lidhet me integritin evropian dhe standardet e transparencës dhe konsultimit publik në procesin legjislativ.

0 1

Procedura e Përshpejtuar për Legjislacionin e Integritit European

Ndryshimet e propozuara në Rregulloren e Kuvendit parashikojnë procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin e legjislacionit që lidhet me procesin e integritit european. Duke pasur parasysh vëllimin e konsiderueshëm të legjislacionit për përafrimin me *acquis* dhe intensifikimin e negociatave, ekzistenca e një mekanizmi të tillë mund të konsiderohet e arsyeshme në parim. Megjithatë, mënyra se si është konceptuar kjo procedurë ngre disa shqetësime që lidhen me funksionimin e procesit parlamentar.

Sipas draftit, procedura e përshpejtuar do të zbatohet automatikisht për të gjithë kategorinë e projektligjeve që lidhen me integritin european, pa një shqyrtim parlamentar rast pas rasti. Kjo shmang filtrin procedural që aktualisht kërkon që urgjenca të propozohet, të arsyetohet dhe të miratohet nga Kuvendi për çdo projektligj të veçantë.

Në mungesë të kësaj garancie, ekziston rreziku që procedura e përshpejtuar të kthehet në mënyrën standarde të miratimit të një numri gjithnjë e më të madh ligjesh — shumë prej të cilave janë teknikisht komplekse dhe me ndikim të rëndësishëm institucional dhe shoqëror. Drafti gjithashtu nuk parashikon afat minimal për shqyrtim në komisione dhe nuk ka mekanizëm rikthimi në procedurë të zakonshme kur kompleksiteti kërkon shqyrtim më të thelluar.

Garanci të tilla nuk pengojnë efikasitetin e procesit legjislativ, por ruajnë balancën midis ritmit të kërkuar nga integriti european dhe rolit kushtetues të Kuvendit. Qëllimi i shqyrtimit legjislativ është arritja e konsensusit sa më të gjerë, që interesat e qytetarëve të pasqyrohen në ligj — duke kontribuar në zbatimin më efektiv nga institucionet publike. Shmangia nga ky proces kufizon pjesëmarrjen e deputetëve, shoqërisë civile dhe qytetarëve, element thelbësor për funksionimin e demokracisë.

0 2

Konsultimi me Shoqërinë Civile dhe Transparenca

Projekt-ndryshimet e propozuara nuk përfshijnë dispozita që garantojnë konsultimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, angazhimin e ekspertëve apo transparencën publike në kontekstin e procedurës së përshpejtuar. Edhe në procedura të përshpejtuara, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve dhe grupeve të interesit kontribuon në përmirësimin e cilësisë së legjislacionit dhe forcimin e legjitimitetit të procesit vendimmarrës. Kur konsultimi mbetet vetëm në diskrecionin e komisioneve parlamentare, ai nuk përbën mekanizëm të strukturuar institucional dhe kufizon parashikueshmërinë e procesit legjislativ.

Vërehet me shqetësim se edhe në procedurën e zakonshme të miratimit të ligjeve që konsiderohen pjesë e piketave të ndërmjetme të integritit european, klima e konsultimit shpesh mbetet formale. Një shembull i fundit është procesi i ndryshimeve në Kodin Penal në dhjetor 2024, ku organizatat që kontribuan në konsultim nuk panë reflektim të rekomandimeve të tyre në propozimin përfundimtar.

Nisur nga kjo situatë, është e nevojshme që Rregullorja të parashikojë standarde të qarta për të garantuar konsultim efektiv me organizatat e shoqërisë civile për nismat ligjore nga procesi i integritit europian. Kjo qasje nuk reflekton plotësisht kuadrin ligjor që aplikohet për procesin e integritit europian në Shqipëri. Ligji nr. 15/2015, i ndryshuar me Ligjin nr. 19/2023, vendos standarde të qarta për transparencën institucionale dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me shoqërinë civile. Rregullorja e Kuvendit është instrumenti procedural përmes të cilit këto parime duhet të operacionalizohen në praktikë.

Në këtë kuptim, transparenca kërkon gjithashtu që publiku, shoqëria civile dhe media të kenë mundësinë të identifikojnë qartë cilat projektligje shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar, mbi çfarë baze procedurale dhe me çfarë dokumentacioni shoqërues — përfshirë publikimin e relacionit shpjegues dhe dokumenteve justifikuese të klasifikimit.

03

Rekomandime

Praktikat parlamentare krahasimore tregojnë se përdorimi i procedurave të përshpejtuara nuk duhet të çojë në eliminimin e fazave të shqyrtimit parlamentar. Studimet tregojnë se "fast-track legislation" duhet të ruajë të gjitha fazat e shqyrtimit parlamentar, por me intervale më të shkurtra, në mënyrë që kontrolli parlamentar të mos eliminohet apo kufizohet. Standardet e rekomanduara sugjerojnë që procedurat e përshpejtuara të shoqërohen me garanci minimale procedurale: detyrimi për justifikim të urgjencës për çdo projektligj; ruajtja e fazave të shqyrtimit në komisione parlamentare dhe konsultimit publik; transparenca e shtuar mbi arsyet dhe bazën procedurale të përshpejtimit.

Përvoja e vendeve që kanë kaluar procesin e negociatave për anëtarësim tregon se ritmi i përafrimit të legjislacionit duhet të shoqërohet me standarde të forta të transparencës, konsultimit publik dhe shqyrtimit parlamentar. Këto elemente nuk janë pengesë për efikasitetin e procesit legjislativ, por garanci për cilësinë, zbatueshmërinë dhe legjitimitetin demokratik të reformave të lidhura me procesin e integritit europian.

Në këtë kuadër, konsiderojmë të domosdoshme që, përpara miratimit të projektvendimit, Kuvendi i Shqipërisë të marrë në konsideratë dhe të reflektojë në tekstin përfundimtar këto garanci procedurale:

- | | |
|-----------|--|
| 1. | Procedura e përshpejtuar të mos aplikohet automatikisht , por të kërkojë një vendim të arsyetuar parlamentar për çdo projektligj të veçantë. |
| 2. | Të garantohet një periudhë minimale shqyrtimi në komisione , të paktën dhjetë ditë pune, edhe kur përdoret procedura e përshpejtuar. |
| 3. | Të vendoset një detyrim për konsultim të strukturuar publik dhe publikimin e akteve në platformën e konsultimit të Kuvendit (e-parlament) , duke mundësuar kontributin e organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve dhe grupeve të interesit edhe në procedura të përshpejtuara. Kuvendi duhet të parashikojë edhe mekanizma të posaçëm konsultimi dhe komunikimi për këto akte, në mënyrë që përshpejtimi i procedurave të mos cenojë cilësinë e procesit legjislativ dhe të konsultimit publik. |

4.	Të garantohet transparencë e plotë për legjislacionin e përsheptuar , përfshirë publikimin e relacionit shpjegues dhe tabelave të përputhshmërisë me acquis.
5.	Të garantohet dhe fuqizohet roli dhe kapaciteti i komisioneve parlamentare sektoriale në shqyrtimin e projektligjeve që lidhen me procesin e integritit evropian.

Procesi i integritit evropian kërkon si efikasitet institucional ashtu edhe legjitimitet demokratik. Ai kërkon jo vetëm shpejtësi institucionale, por edhe standarde të larta demokratike. Përsheptimi i procedurave nuk duhet të dobësojë transparencën, konsultimin publik dhe rolin kushtetues të Kuvendit në shqyrtimin e ligjeve.

Këtë deklaratë e paraqesim në frymë konstruktive dhe mbetemi të gatshëm për dialog me Kuvendin dhe institucionet përkatëse mbi çështjet e ngritura.

0 4

Organizatrat Nënshkruese

1.	Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)
2.	Albanian Woman in Audiovisual (AWA)
3.	Partners Albania
4.	Akademia e Studimeve Politike (ASP)
5.	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)
6.	Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" (GADC)
7.	Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH)
8.	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER)
9.	Instituti i Studimeve Politike (ISP)
10.	Aleanca Kundër Diskriminimit LGBTI
11.	Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA-ECPAT Shqipëri)
12.	BIRN Albania
13.	Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë (AGSH/AJA)
14.	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
15.	Faktoje
16.	Rrjeti Erasmus Tirana (ESN Tirana)
17.	Fondacioni "Së Bashku"
18.	Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI)
19.	Instituti Shqiptar i Shkencës / Open Data Albania
20.	Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive
21.	Këshilli Shqiptar i Medias (KSHM)
22.	Qendra Për Studime të Krahasuara dhe Ndërkombëtare (QSKN)

23.	Qendra Amfora
24.	Qëndresa Qytetare
25.	Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore (ACQJ)
26.	Shoqata Together for Life (TFL)
27.	Qendra "Strehëza Edlira Haxhiymeri"
28.	Rrjeti i Grave — Barazi në Vendimmarrje
29.	Qendra për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm — All Green Centre
30.	Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
31.	AWEN — Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
